



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR
NË DREJTIMIN MËSIMOR "INSTALUES I SISTEMEVE
TERMOHIDRAULIKE (PILOT-A1bVET)", NIVELI III**

TIRANË, 2015

Programi orientues për provimet përfundimtare të drejtimit mësimor **“Instalues i Sistemeve Termohiraulike (pilot-AlbVET)”**, Niveli III përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë drejtim mësimor, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta apo në arsimin pas të mesëm.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësuesit/instrukturët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në drejtimin mësimor **“Instalues i Sistemeve Termohiraulike (pilot-AlbVET)”**, Niveli III është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit :

Nr	Kompetenca profesionale
1	Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
2	Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
3	Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit si dhe veprimet kryesore për dhënien e ndihmës së shpejtë.
4	Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë profesionale përkatëse.
5	Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacione që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
6	Të kryejë në mënyrë të pavarur instalimet sanitare dhe ato të ngrohjes të një apartamenti apo banese të vogël dhe të zbatojë nën mbikëqyrje projekte të mëdha e komplekse të instalimeve termohidraulike.

7	Të inspektojë, mirëmbajë dhe riparojë sistemet e ngrohjes, të furnizimit me ujë dhe të shkarkimit.
8	Të projektojë, të llogaritë dhe të skicojë instalime funksionale panelesh diellore dhe instalime komplekse sanitare.
9	Të këshillojë klientët dhe të zbatojë porosi pune me nivele vështirësie të ndryshme.
10	Të zbatojë standardet teknike të profesionit të instaluesit të sistemeve termohidraulike.
11	Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit për qëllime të profesionit përkatës.

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve “*me projekt vlerësimi*” dhe “*me poste pune*”. Vlerësimi i nxënësit do të jetë vlerësim në grup (gjatë realizimit të projektit) dhe individual (gjatë kalimit në disa poste pune, të cilat përzgjidhen nga vetë shkolla).
- Nxënësit do të vlerësohen për të gjitha kompetencat e listuara më sipër.
- Specifikimet e vlerësimit do të jepen me udhëzim të veçantë.